



KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR.2/13, DATË 14/07/2016

PËR MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK “GREEN COAST”

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 22 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozimin e Agjencisë, vlerëson se:

Vlera e investimit të projektit “Green Coast” plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 52,530,160 (pesëdhjetë e dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Euro.

Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Numri i të punësuarve planifikohet 150 persona, ndërsa niveli maksimal do të jetë 250 persona. Njëkohësisht do punësohen dhe 250 punonjës të tjerë, të cilët lidhen me fazat e ndërtimit.

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Green Coast”.
2. Projekti “Green Coast” do të realizohet nga subjekti Green Coast shpk me NIPT/NUIS: L41329038D me kontraktor kryesor Mane TCI, NIPT/NUIS K22203004A.
3. Projekti strategjik parashikon realizimin e investimeve në sektorin strategjik të turizmit.
4. Projekti përfshin ndërtimin e një kompleksi turistik, i cili shtrihet në një sipërfaqe totale prej 183,500 m², me Nr. Pasurie nga 40 deri në 78, të ndodhura në zonën kadastrale 1481, në Palasë, Dhërmi, Himarë.

5. Statusi strategjik “Investim strategjik me procedurë të veçantë” i jepet projektit të investimit “Green Coast”, për një periudhë katër vjeçare, përveç afatit të lejitimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit, i cili do të vendoset me Vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:
 - a) Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përsheptuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit;
 - c) Miratimin në parim dhe lejimin e përdorimit të bregut të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit përpara kompleksit, me koordinata sipas sistemit Shtetëror Shqiptar: X =379726.364 Y = 4449326.899; X= 379655.557 Y = 4449203.607; X = 379461.741 Y = 4449455.824; X = 379252.265 Y = 4449694.718; X = 379364.164 Y = 4449695.190; X 379504.140 Y = 4449513.156.
Miratimi përfundimar, si dhe mënyra, afatet, kostot e lejitimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas procedurave të legjislacionit për investimet strategjike;
 - d) Infrastrukturë ndihmëse, për sa i përket nevojave për furnizim dhe përshtatje të rrjetit elektrik, furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizim dhe trajtim të ujërave të ndotura dhe infrastrukturë rrugore;
 - e) Asistencë në lidhje me kryerjen e veprimeve në lidhje me konsolidimin e tokës, mundësimin e hedhjes së zonës së zhvillimit në sistemin e ZRPP dhe fillimin e procesit të regjistrimit fillestar.
7. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Green Coast”, konstatohen të dhëna të pavërteta apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e këtij projekti në procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
8. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet ne regjistrin e investimeve strategjike.
9. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK GREEN COAST

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

2. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit Green Coast

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit Green Coast, projekt me potencial strategjik, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit përmban të gjitha angazhimet e administratës shtetërore, që nga momenti i paraqitjes së propozimit investues për përfshirjen në procedurat administrative për përfitimin e statusit “Investitor strategjik, procedurë e veçante” të projektit Green Coast e deri në përfundimin e të gjitha procedurave administrative të parashikuara për realizimin e projektit investues.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e

paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, lejet, licencat, autorizimet dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit Green Coast është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

Me qëllim transparencën, sigurinë juridike dhe mirëkuptimin midis investitorëve strategjike dhe shtetit shqiptar, elementët përbërës të planit të veprimit, mund të përfshihen dhe të pranohen nga të dy palët, nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshje të posaçme për realizimin e investimit strategjik.

Kjo marrëveshje e cila përcakton zotimet dhe angazhimet e ndërsjella të palëve për realizimin e projektit investues strategjik mund të jetë një marrëveshje mirëkuptimi ose një marrëveshje detyruese, midis palëve.

3. Hapat procedurale

Propozimi nga investitor:

Investitori GREEN COAST, kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

| Masat e kërkuara | Rekomandimi | Institucioni përgjegjës | Procedura për masën e kërkuar e detajuar në fazë. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse | Dokumentacioni nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti | Afati | Kosto |
|--|--------------------|--------------------------------|---|---|--------------|--------------|
| Marrje në përdorim afatgjatë e plazhit përpara kompleksit | PO | MZHETTS | Procedura, afati, struktura kompetente dhe detyrimi mbi lejimin e përdorimit | | | |

| | | | | | | |
|--|----|-------------|--|--|---|--|
| | | | të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave (bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.55/2015) | | | |
| Mundësimi i hedhjes së zonës së zhvillimit në sistemin e ZRPP dhe fillimin e procesit të regjistrimit fillestar | PO | ZRPP | Hedhja e zonës në sistemin e ZRPP Vlorë është parakusht për marrjen nga ana e subjektit të lejes së ndërtimit. Subjekti do të asistohet nga AIDA përgjatë procesit së zgjidhjes së problematikës. ZRPP Vlorë është kontaktuar zyrtarisht datë 8.7.2016 lidhur me problematikën. AZHT është në proces të lëshimit të dokumentit | Subjekti paraqet pranë AZHT-së: 1. Vërtetim | 10 ditë (afati fillon vetëm pasi të jetë i plotë i gjithë dokumentaci | Taksa e ndikimit në Infrastruktura për |

| | | | | | | |
|---|----|---|--|--|---|--|
| | | | të Lejeve të Ndërtimit sipas nukleve përbërëse të Lejes Zhvillimore Komplekse, miratuar në KKT me Vendim nr. 8, datë 07.03.2014 | Hipotekor për secilën parcelë 2. Projekt Zbatimin 3. Preventivin për realizimin e punimeve 4. Faturën e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Himarë. | oni | llogari të Bashkisë Himarë |
| Përmirësime dhe rritje e kapacitetit në rrjetin e furnizimit me energji elektrike të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. | PO | OSHEE VLORË Strukturat që merren me realizimin e lidhjes së re janë: 1. Kujdesi ndaj klientit (nisja e procedurës nga aplikanti) 2. Zyrat e lidhjeve të reja në rajone (nqs fuqitë e instaluara për të cilat kërkohet lidhja e re janë nën 50 | Furnizimi aktual Green Coast furnizohet aktualisht nga një linjë ajrore e TM 10 Kv, Fideri 2, Nënstacioni Himarë, e cila përfundon në Palasë. Prej Palasës deri në kompleksin Green Coast vetë investitori ka ndërtuar një linjë të re ajrore me izolacion dhe parametra 20 Kv e cila | Hapat proceduriale 1. Kërkesë me shkrim pranë zyrave të OSHEE për pikë lidhje të re. 2. Përgatitja e dokumentacionit përkatës. 3. Miratimi nga ana e OSHEE e pikës së lidhjes. 4. Nënshkrimi i akt marrëveshjes midis kompanisë dhe aplikuesit 5. Kryerja e punimeve 6. Kryerja e | Koha që duhet për realizimin e një lidhje të re varion sipas fuqive nga 15 ditë deri në 45 ditë. Kjo procedurë do të trajtohet me afate të përshpejtuar, sipas parashikimeve të Nenit 23 të Ligjit nr. 55/2015 | Nqs do të kemi një lidhje të re ne TU për abontenet familjarë duhet paguar: -T2, tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re (1200 lekë) -T3, tarifa e fuqisë (2000 lekë/kw fuqi të kërkuar) -T4, tarifa për kolaudim fillestar të |

| | | | | | |
|--|--|--|---|---|--|
| | | <p>kw)</p> <p>3. Zyrat e lidhjeve të reja në Drejtorinë Qendrore Tiranë (nqs fuqitë e instaluara janë mbi 50 kw)</p> <p>4. Grupet e asistences teknike në rajonë për realizimin e lidhjes së re dhe montimin e matësave</p> <p>5. Zyra e menaxhimit të kontratave në drejtorinë qendrore për finalizimin e procedurës duke nxjerrë kontratën për lidhjen e re.</p> | <p>është në pronësi, përdorim dhe mirëmbajtje të vetë investitorit. Kjo linjë pavarësisht se është me parametra 20 kv është në shfrytëzim me tension 10 kv.</p> <p>Prespektiva afatshkurtë</p> <p>Është në përfundim dhe vendoset së shpejti në punë një linjë e re me parametra 20 kv prej nënstationit të ri "mobile" 110/35/10 kv që është instaluar në Himarë.</p> <p>Kjo linjë që përfundon në një pikë shpërndarëse në Palasë, në një degëzim të saj do të</p> | <p>pagesave sipas preventiviv përkatës.</p> <p>7. Lajmërimi në kompani për përfundimin e punimeve.</p> <p>8. Verifikimi dhe kontrolli nga ana e OSHEE të punimeve që janë kryer para vënies në tension të pajisjeve.</p> <p>9. Pajisja me matës të energjisë sipas fuqive përkatëse.</p> <p>10. Dhënie tension (në rast se gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, të instaluara nga aplikanti, atëhere aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale derisa skema</p> | <p>matësit të energjisë elektrike (1462 lekë) – tvsh</p> <p>Nqs do të kemi një lidhje të re ne TU për abonentë privatë (njësi shërbimi) duhet paguar:</p> <p>-T2, tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re (1200 lekë)</p> <p>-T3, tarifa e fuqisë (2500 lekë/kw fuqi të kërkuar)</p> <p>-T4, tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike (1462 lekë)-tvsh</p> <p>Nqs do të kemi një lidhje të re të</p> |
|--|--|--|---|---|--|

| | | | | |
|--|--|---|---|--|
| | | <p>furnizojë linjën e ndërtuar nga investitori i Green Coast.</p> <p>Gjithashtu në të njëjtat shtylla me dy qarqe që transmetojnë tensionin 10 kv është instaluar qarku i rrjetit 35 kv që furnizon nënstationin e ri 35/20/10 kv të Palasës, përfundimi i të cilit parashikohe t në muajin shtator 2016 dhe që do të furnizojë me një celë të vecantë dhe linjën ajrore të Green Coast.</p> <p>Pra brenda këtij sezoni veror Green Coast do të ketë një furnizim me të mirë dhe më të sigurt me rrjetin shpërndarës të TM 10 kv.</p> | <p>e plotë të funksionojë normalisht)</p> <p>11.Përfundimi i procedurës me daljen në sistemin e faturimit të kontratave përkatëse.</p> <p>Dokumentacioni</p> <p>1. Kërkesë për pikë lidhje të re (projekti elektrik i objektit dhe pikës së transformatorit i miratuar paraprakisht në IQT nqs fuqitë e instaluara janë mbi 20 Kw)</p> <p>2. Leje ndërtimi</p> <p>3. Vërtetim pronësie apo leje të tjera të vecanta për zhvillim</p> <p>4. NIPT+ ekstakt QKB të subjektit aplikues</p> <p>5. Kartë identiteti e personit</p> | <p>Tm për abonentë privatë (njësi shërbimi) dhe abonentë familjarë duhet paguar:</p> <p>-T1, tarifa për studimin dhe vlerësimin e miratimit të projektit (4000 lekë)</p> <p>-T2, tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re (1200 lekë)</p> <p>-T3, tarifa e fuqisë (1700 lekë/kw fuqi të kërkuar)</p> <p>-T4, tarifa për kolaudim fillestar të matësit të energjisë elektrike (1462 leke)tvsh</p> |
|--|--|---|---|--|

| | | | | | | |
|--|--|--|---|---|--|--|
| | | | <p>Prespektiva afatmesme</p> <p>Në zonën e Himarës janë duke përfunduar projekt-preventivat dhe së shpejti do të fillojnë punimet për ndërtimin e një nënstacioni të ri 110/20 kv nga kompania OST, si dhe linjave shpërndarës e të TM 20 kv.</p> <p>Këto investime të parashikuara të fillojnë në vitin 2017, të paraprir nga investimi tashmë i përfunduar i unazës 110 kv të jugut do të përmirësojnë sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji të gjithë</p> | <p>përfaqësues</p> <p>6. Plan vendosje e objektit në formatin A-3 në sh: 1 me 500</p> <p>7. Parametrat nominal të të gjitha pajisjeve elektrike të përfshira në projektin elektrik.</p> <p>8. Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlllogaritja e të dhënave të kryera nga inxhinierë me licence.</p> <p>9. Relacion analitik për vlerësimin e cos fi dhe kompensimin e saj.</p> <p>10. Licence e ing. Elektrik i cili ka bërë projektin e noterizuar.</p> | | |
|--|--|--|---|---|--|--|

| | | | | | | |
|---|----|---|---|---|--|--|
| | | | <p>bregut të Himarës, përfshirë Kompleksin Green Coast. Në përfundim të këtij investimi edhe linja ajrore e ndërtuar për Green Coast do të vihet në punë me tension 20 kv, duke qene se parametrat e ndërtimit i ka në këtë nivel tensioni.</p> | | | |
| <p>Përmirësime dhe rritje e kapacitetit në rrjetin e furnizimit me ujë, mundësi lidhje me sistemin e furnizimit me ujë të bashkisë Himarë.</p> | PO | <p>BASHKIA HIMARE DPUK</p> <p>Në bazë të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimie ve përcaktohet si funksion i vetënjësive vendore.</p> | <p>Përpara se të merret leja e ndërtimit, në studim fizibiliteti përcaktohet sasia e nevojshme e ujit. Kërkesa me kapacitetet e kërkuara paraqitet për miratim pranë Drejtorisë së Ujësjellësit.</p> | <p>Kërkesë me shkrim e cila shoqërohet nga studimi i fizibilitetit.</p> | <p>Kjo procedurë do të trajtohet me afate të përshpejtuar a, sipas parashikimeve të Nenit 23, të ligjit Nr. 55/2015.</p> | |

| | | | | | | |
|--|----|--|--|--|---|--|
| | | Në bazë të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 ky shërbim u transferohet në masën 100% bashkive të reja sipas ndarjes së re territoriale - administrative | | | | |
| Lehtësim i procedurave për pajisje me lejen përkatëse në institucionet e linjës për Impiantin e Përpunimit të Ujërave të Zeza | PO | BASHKIA HIMARE DPUK Në bazë të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimie ve përcaktohet si funksion i vetënjësive vendore. Në bazë të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 ky shërbim | | | Subjekti do të asistohet nga AIDA për të gjitha procedurat. Kjo procedurë do të trajtohet me afate të përshpejtuar, sipas parashikimeve të Nenit 23, të ligjit Nr. 55/2015. | |

| | | | | | | |
|--|--|---|--|--|---|--|
| | | <p>u transferohet në masën 100% bashkive të reja sipas ndarjes së re territoriale - administrative</p> <p>MM</p> | <p>Përpara ndërtimit, Projekti duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM paraprake, referuar Shtojcës II/pika3/b të Ligjit 10440/2011 sipas procedurave të përcaktuara në VKM Nr. 686, datë 29.07.2015</p> | <p>Kërkesë me shkrim dhe dokumentacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raport teknik të projektit të propozuar (plotësohet nga zhvilluesi me mbështjetjen e ekspertit të Vnm-së) 2. Raport paraprak të VNM-së i cili do të jetë i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licensuar. 3. Akt regjistrimi të personit fizik/juridik sipas legjislacionit në fuqi (Ekstrakti i QKB) | <p>Afati total për tu pajisur me Vendim për VNM paraprake nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është 45 ditë nga data e aplikimit në Ministrinë e Mjedisit.</p> <p>Kjo procedurë do të trajtohet me afate të përshpejtuar, sipas parashikimeve të Nenit 23 të Ligjit Nr.55/2015.</p> | <p>Tarifa e shërbimit për t'u paguar në shtet është 30.000 ALL</p> |
|--|--|---|--|--|---|--|

| | | | | | | |
|---|--|------------------------------|---|---|--|--|
| | | | | <p>4. Një kopje të faturës së pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi. (30.000 ALL)</p> <p>Dokumentacioni i kërkuar më sipër, dorëzohet dhe me CD/DVD (i skanuar), në të paktën 10 kopje.</p> | | |
| <p>Suport në infrastrukturën rrugore, duke marrë në konsideratë nevojat e investimit strategjik</p> | <p>PO, me kusht. Nëse subjekti vendos të investojë në ndërtimin e rrugës, të asistohet për hapat proceduralë dhe dokumentacionin</p> | <p>Bashkia Himarë</p> | | | | |
| <p>Lehtësim i procedurave për pajisjen me leje të infrastruktura ve ujore dhe pajisje me leje përkatëse për Stacion Vend-Qendrim të mjeteve ujore;</p> | <p>PO</p> | <p>AZHT</p> | <p>AZHT do të vijojë me marrjen në shqyrtim për miratim në KKT të projektit lungomare, pasi të zbardhet vendimi i</p> | <p>1. Dokumentacioni i pronësisë; 2. Miratimi nga KKU për veprimtari në brigje. 3. Miratimi nga Ministria</p> | <p>10 ditë (afati fillon vetëm pasi të jetë i plotë i gjithë dokumentacioni)</p> | <p>Taksat që duhen paguar pranë Bashkisë Himarë.</p> |

| | | | | | | |
|--|--|-----------|---|--|--|--|
| | | MM | <p>KIS.</p> <p>Për çdo projekt që do të investohet, nëse do të jetë objekt i Ligjit Nr.10440/2011, përpara ndërtimit projekti duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM paraprake. (Procedura për VNM e njejtë si e paraqitur më lart.)</p> | <p>e Mjedisit.</p> <p>4. Projekt zbatimi</p> | | |
|--|--|-----------|---|--|--|--|

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTËR I FINANCAVE

ARBEN AHMETAJ

**MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK TURIZMIT TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES**

MILVA EKONOMI

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

EDMOND HAXHINASTO

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIËS

DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

EGLANTINA GJERMENI

**MINISTËR I BUJQËSISË ZHVILLIMIT URBAN DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE**

EDMOND PANARITI

MINISTËR I MJEDISIT

LEFTER KOKA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ALMA HIÇKA